

Taksa e ambientit për ambientin

Zhvillimi i industrisë dhe përdorimi i makinave ka bërë të mundur që ajri të cilin ne e thithim të jetë mjaft i ndotur sidomos në zonat urbane ku është e përqendruar edhe popullsia me e madhe.

Për efektet nga ndotja e ajrit, janë bërë një varg studimesh të cilat tregojnë dëmtimin jo vetëm të shëndetit por edhe të mjedisit në tërësi.

Kosova me një territor relativisht të vogël, prej vetëm 11 mijë km katrorë sipas ekspertëve, i ka katër ndotës të mëdhenj, KEK-u, Ferronikeli, Trepça, Sharr Cemi. Mirëpo këtu hynë edhe ndotësi i pestë, e që janë makinat, pompa karburantesh që përbëjnë një ndotje potenciale për një hapësirë kaq të vogël sa është Kosova.

Vlerësimi i përgjithshëm për tërë Kosovën është që, në një situatë ku mbizotërojnë tema të nxehta politike, ne nuk po e vërejmë se mjedisi jonë po kërcënohet, se ka gjithnjë e më shumë ndotje dhe se ndikimet e ndotjes së mjedisit në zhvillimin normal të shoqërisë janë nënvlerësuar.

EKOSOVA, është një iniciativë e cila ka dalë nga “Akademia e Grave për Leadership” program i NDI dhe USAID në Kosovë.

Kjo iniciativë është fokusohet në trajtimin e taksës ekologjike dhe qëllimi kryesor i kësaj iniciative është:

- ▶ Zbatimi i ligjit në fuqi (nr.04/L-117) i cili rregullon mbledhjen e taksës rrugore dhe ekologjike. Duke marrë parasysh që kjo taksë paguhet nga vetë qytetarët dhe shumata e paguara nuk janë të vogla për nivelin e jetesës në Kosovë, është e drejtë e qytetarëve që paratë e tyre të dërgohen në destinacionin e paraparë me ligj.
- ▶ Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e ambientit tek qytetarët
- ▶ Decentralizimi i buxhetit të ambientit nëpër komuna në përputhje me të hyrat nga taksa e mjedisit

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) e ka vlerësuar shumë të nevojshme e të dobishme iniciativën dhe me datën 28 tetor 2015 kemi formalizuar partneritetin dhe bashkëpunimin për realizimin e projektit hulumtues që ka për qëllim të zgjojë organet kompetente që të fillojnë me zbatimin e mirëfilltë të ligjit për taksën ekologjike i cili sqaron se mjetet e mbledhura nga taksa, shkojnë në buxhetin e shtetit për tu investuar në mbrojtjen e mjedisit dhe decentralizimi i buxhetit të mjedisit nëpër komuna në përputhje me të hyrat nga taksa e mjedisit.

Si produkt final i kësaj iniciative do të jetë përpilimi një dokumenti politikash i cili do të elaborojë çështjen e taksës ekologjike.

Aktiviteti i fundit do jete konferenca me daten 13 tetor 2015 ku do prezantohet studimi. Ne kete konference do kete pjesemarrres edhe nga ministrite dhe komunat. Konferenca do shoqerohet nga diskutime dhe ndarje mendimesh mbi te gjeturat nga hulumtimi i kryer.

Dokumenti i realizuar do shperndahet tek partneret nepermjet emailit dhe gjithashtu ai do të publikohet ne faqen e website te FIQ-it.

